Dalë nga Arshiva

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**Komuna Brataj**
**Qarku Vlore**

**Nr. Prot.** 495/1 **DATA 25/04/2015**

## KONTRATE PER KOLAUDIM PUNIMESH

Kjo kontrate hartohet bazuar ne dispozitat e pergjithshme te Kodit Civil, ligjin nr.8402 dt.10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" ndryshuar me ligjin nr.9794 dt.23.07.2007, ne VKM nr.444 dt.05.09.1994 "Per tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit te veprave te ndertimit", Udhezimin e Keshillit te Ministrave nr.3 dt.15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e puneve te ndertimit" ndryshuar me Udhezimit nr.4 dt.17.05.2001.

Objekti i kesaj kontrate eshte kolaudimi i punimeve te zbatimit te vepres: **"Rikonstruksion Shkolla** Hamdi Rrapi '' Gjorm

Kjo kontrate lidhet sot me date **25/04/2015** midis

1. Komunes Brataj te perfaqesuar nga Kryetari i saj, Z. Pilo Toto i quajtur "INVESTITOR".

dhe

2. Znj.Erimjona Vongli i quajtur "Kolaudator i punimeve" me NIPT K86606201G

Duke u nisur nga fakti se Komuna Brataj ka nenshkruar nje kontrate sipermarrje punimesh me shoqerine "----------------------------------------------, per ndertimin e objektit te mesiperm vepres:

**"Rikonstruksion Shkolla Hamdi Rrapi '' Gjorm**

Me te drejten e Investitorit duke pasur parasysh edhe propozimin e dhene nga Ministria e Puneve Publike, Trasportit dhe Telekomunikacionit, Drejtoria e Pergjithshme Rregullatore (Drejtoria e Licencave, me shkresen Nr. 564 prot., date 24.01.2008) Kolaudator punimesh caktohet:

**Person Fizik "Erimjona Vongli "**

**PALET BIEN DAKORT ME KUSHTET E MEPOSHTME :**

**1.** Kolaudatori i punimeve pergjigjet :

a. realizimin e objektit ne perputhje me projektin, lejen e ndertimit, standartet dhe rregullat teknike.
b. realizimin e objektit ne perputhje me kontraten e nenshkruar.
c. perputhjen e dokumentave me te dhenat nga matjet ne dimension, forme, sasi dhe cilesi.
d. perputhjen e vleres se preventivuar dhe te kontraktuar me ate te paraqitur ne situacionin perfundimtar, si dhe sqarimet perkatese ne rastet e mosperputhjes.

**2.** Kur verehen difekte ne verifikimet qe percaktihen ne piken 1, kolaudatori le detyra me shkrim per punimet qe duhet te kryhen, duke percaktuar afatet e perfundimit te tyre ne menyre qe te plotesohen te gjitha kushtet e pikes 1. Ne varesi nga natyra e ketyre difekteve percaktohen detyrimet e sejciles pale.

3. Kolaudimi i vepres ne fund te punimeve eshte i detyrueshem.

4. Zhbllokimi i garancise se kontrates do behet pasi te jete perfunduar plotesisht kolaudimi i punimeve, ndersa 5% i garancise se punimeve per periudhen pas kolaudimit zhbllokohet pas perfundimit te garancise se objektit.

5. Kolaudatori pas kolaudimit te objektit harton procesverbalin e kolaudimit, i cili firmoset nga kolaudatori, sipermarresi dhe mbikqyresi i punimeve. Procesverbali duhet te permbaje:

a. Vendin e ndertimit
b. Emertimin e objektit dhe funksionin e tij
c. Daten dhe prejardhjen e projekteve si dhe ndryshimet e bera ne to.
d. Vleren e objektit
e. Gjenialitetet e sipermarresit
f. Afatin e ndertimit
g. Vleren e shpenzimeve (sipas rregjistarve te kontabilitetit)
h. Gjenialitetet e kolaudatorit dhe specialitetet perkatese
i. Kohezgjatjen e kolaudimit
j. Pershkrimin e verifikimeve te bera mbi dokumentet dhe faktin si dhe rezultatet e arritura
k. Procesverbali paraqitet ne tre kopje dhe mbas rregjistrimit kopjet i dergohen punedhenesit.

6. Kur shkeljet e dispozitave ligjore nuk perbejne veper penale denohen me gjobe nga 50 000 deri ne 200 000 leke, sipas ligjit "Per Kontrollin e Disiplinimin e Ndertimeve " Ne rast se mbikqyrsi kryen shkelje financiare dhe penalitete pergjigjet para ligjeve ne fuqi.

7. Kolaudatori i punimeve per kohen e punes, eshte ne dispozicion te investitorit, paguhet prej tij me shumen:3 200 pa tvsh

Per cdo ceshtje qe nuk eshte e rregulluar ne kete kontrate, si baze per zgjidhjen e saj do te merren dispozitat ligjore te permendura ne fillim te kontrates.

8. Per çdo mosmarrveshje palet duhet t'i drejtohen Gjykates Vlore per zgjidhjen e ketyre mosmarrveshjeve.

9. Kjo kontrate behet ne pese kopje, nga te cilat nje mban mbikqyresi, dy kopje investitori, nje kopje Drejtoria e Infrastruktures dhe nje kopje sipermarresi i punimeve.

| | |
|---|---|
| **KOLAUDATOR** | **INVESTITORI** |
| **Ing Erimjona Vongli** | **K R Y E T A R I**<br>**Pilo TOTO** |